VENDIM
Nr. 316, datë 31.5.2018

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 883, DATË 13.5.2009, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E TARIFAVE PËR REGJISTRIMIN E OBJEKTEVE TË PRONËSISË INDUSTRIALE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 193/d, 198, 198/c dhe 202, të ligjit nr. 9947, datë 7.7.2008, "Për pronësinë industriale", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 883, datë 13.5.2009, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon:

1. Kudo në vendim, emërtimet "DPPM" zëvendësohen me "DPPI", dhe "Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave" me "Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale".

2. Në pikën 6, pas fjalëve "... treguesit gjeografikë ..." shtohen "... dhe emërtimeve të origjinës ...".

3. Pika 11 shfuqizohet.

4. Lidhja nr. 1, "I. Tarifat për patentat e shpikjeve", bashkëlidhur vendimit, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numërtim që i bashkëlidhet këtij vendimi.

5. Në lidhjen nr. 3, "III. Tabela e tarifave të shërbimit për modelet e përdorimit", bashkëlidhur vendimit, bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë:

a) Nënndarja 3.23 shfuqizohet;

b) Pas nënndarjes 3.32 shtohen nënndarjet 3.33 dhe 3.34, me këtë përmbajtje:

"3.33 / Tarifë për regjistrimin e kontratës së pengut / 5 000

3.34 / Tarifë për regjistrimin e veprimeve përmbarimore / 5 000.".

6. Në lidhjen nr. 4, "IV. Tabela e tarifave të shërbimit për disenjot industriale", bashkëlidhur vendimit, bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë:

a) Nënndarja 4.5 shfuqizohet;

b) Në nënndarjen 4.13, pas fjalës "... industriale ..." shtohet "... e regjistruar ...";

c) Nënndarja 4.15 shfuqizohet;

ç) Në nënndarjen 4.17, pas fjalës "... disenjos ..." shtohen fjalët "... në dhomën për shfuqizim/zhvlerësim ...";

d) Në nënndarjen 4.23 hiqen fjalët "... për plotësim dokumentacioni ...".

dh) Nënndarja 4.24 shfuqizohet;

e) Pas nënndarjes 4.25 shtohen nënndarjet 4.26, 4.27, 4.28, 4.29, 4.30, 4.31 dhe 4.32, me këtë përmbajtje:

"4.26 / Tarifë për rivendosjen në afat të të drejtave/7 000;

4.27 / Tarifë për apelimin në bordin e apelit / 10 000;

4.28 / Tarifë për shfuqizimin e një disenjoje të regjistruar në dhomën për shfuqizim/zhvlerësim / 7 000;

4.29 / Tarifë për regjistrimin e kontratës së pengut / 5 000;

4.30 / Tarifë për regjistrimin e veprimeve përmbarimore / 5 000;

4.31 / Tarifë për saktësimin e të dhënave në regjistër / 2 000;

4.32/ Tarifë për pasqyrimin e ndryshimeve të tjera në regjistër / 5 000.".

7. Lidhja nr. 5, "V. Tabela e tarifave të markave", bashkëlidhur vendimit, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numërtim që i bashkëlidhet këtij vendimi.

8. Në lidhjen nr. 6, "VI. Tabela e tarifave të shërbimit për treguesit gjeografikë", bashkëlidhur vendimit, bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë:

a) Emërtimi i tabelës ndryshohet, si më poshtë:

"VI. TABELA E TARIFAVE TË SHËRBIMIT PËR TREGUESIT GJEOGRA-FIKË DHE EMËRTIMEVE TË ORIGJINËS ".

b) Në nënndarjen 6.1, pas fjalëve "Tarifë për depozitimin e aplikimit për regjistrimin e treguesit gjeografik" shtohen "... dhe emërtimeve të origjinës.";

c) Në nënndarjet 6.2 dhe 6.3, pas fjalëve "... treguesi gjeografik ..." shtohen "... dhe emërtimi të origjinës.";

ç) Në nënndarjen 6.4, pas fjalëve "... treguesit gjeografikë" shtohen "... dhe emërtimeve të origjinës te

dhoma për shfuqizim/ zhvlerësim ...";

d) Nënndarjet 6.5, 6.6 dhe 6.7 shfuqizohen;

dh) Në nënndarjet 6.8, 6.9 dhe 6.10, pas fjalëve "... treguesit gjeografikë ..." shtohen "... dhe emërtimet e origjinës.";

e) Nënndarjet 6.13 dhe 6.14 shfuqizohen;

ë) Pas nënndarjes 6.14 shtohen nënndarjet 6.15, 6.16 dhe 6.17, me këtë përmbajtje:

"6.15 / Tarifë për ndryshimet në specifikimet e produktit / 8 000

6.16 / Tarifë e apelimit në bordin e apelit / 10 000 ALL

6.17 /Tarifë për shfuqizim/zhvlerësim në dhomën për shfuqizim/zhvlerësim" dhe vlerë / 7 000.".

9. Lidhja nr. 8, "VIII. Tabela e tarifave të tjera", bashkëlidhur vendimit, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numërtim që i bashkëlidhet këtij vendimi.

II. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Lidhja nr. 1

I. TABELA E TARIFAVE PËR PATENTAT E SHPIKJEVE

Nr.	Llojet e tarifave	Vlera në lekë
1.1	Tarifë për depozitim aplikimi për patentë	7 000
1.2	Tarifë për depozitimin e aplikimeve të PCT-së	7 000
1.3	Tarifë për çdo pretendim mbi pretendimin e 10-të të patentës	500
1.4	Tarifë për depozitimin e çdo aplikimi të ndarë të patentës	5 000
1.5	Tarifë për publikimin e shtrirjes së patentave evropiane dhe amendamenteve në patentë	1 000
1.6	Tarifë për publikim të parakohshëm të patentës	2 000
1.7	Tarifë për rivendosjen në afat të të drejtave	7 000
1.8	Tarifë për shqyrtim të mëtejshëm	7 000
1.9	Tarifë për korrigjimin e gabimeve në aplikimin për patentë	2 000
1.10	Tarifë për korrigjimin e gabimeve në patentë	2 000
1.11	Tarifë për lëshimin e patentës	6 000
1.12	Tarifë për depozitimin e kundërshtimit të dhënies së patentës	7 000
1.13	Tarifë për apelim në Bordin e Apelimit	7,000
1.14	Tarifë për regjistrimin e transferimit të pronësisë mbi aplikimin për patentë ose patentën	5 000
1.15	Tarifë për regjistrimin e ndryshimit të emrit të aplikantit/pronarit të patentës	5 000
1.16	Tarifë për regjistrimin e ndryshimit të adresës së aplikantit/pronarit të patentës	3 000
1.17	Tarifë për regjistrimin e kontratës së licencës mbi patentën	5 000
1.18	Tarifë për lëshimin e ekstraktit të regjistrit për një patentë	1 500
1.19	Tarifë për kryerjen e hetimit mbi një patentë	2 000

1.20	Tarifë për lëshimin e dublikatave	1 000
1.21	Tarifë për lëshimin e dokumentit të prioritetit për një patentë	3 000
1.22	Tarifë për inspektim dosje të patentës	1 000
1.23	Tarifë ripërtëritje viti II	5 000
1.24	Tarifë ripërtëritje viti III	6 000
1.25	Tarifë ripërtëritje viti IV	8 000
1.26	Tarifë ripërtëritje viti V	10 000
1.27	Tarifë ripërtëritje viti VI	12 000
1.28	Tarifë ripërtëritje viti VII	14 000
1.29	Tarifë ripërtëritje viti VIII	18 000
1.30	Tarifë ripërtëritje viti IX	20 000
1.31	Tarifë ripërtëritje viti X	25 000
1.32	Tarifë ripërtëritje viti XI	27 000
1.33	Tarifë ripërtëritje viti XII	30 000
1.34	Tarifë ripërtëritje viti XIII	35 000
1.35	Tarifë ripërtëritje viti XIV	40 000
1.36	Tarifë ripërtëritje viti XV	45 000
1.37	Tarifë ripërtëritje viti XVI	50 000
1.38	Tarifë ripërtëritje viti XVII	55 000
1.39	Tarifë ripërtëritje viti XVIII	60 000
1.40	Tarifë ripërtëritje viti XIX	65 000
1.41	Tarifë ripërtëritje viti XX	70 000
1.42	Tarifë për transferimin e aplikimeve të bëra në bazë të PCT-së	9 000
1.43	Tarifë për kërkesë për ndryshimin ose shtimin e prioritetit	7 000
1.44	Tarifën shtesë, për zgjatje afati	7 000
1.45	Tarifë për publikimin e vlefshmërisë së patentave evropiane dhe amendamenteve në patentë	10 000
1.46	Tarifë për regjistrimin e kontratës së pengut	5 000
1.47	Tarifë për regjistrimin e veprimeve përmbarimore	5 000

* Tarifat vjetore për ripërtëritjen e patentave (nr. rendor 1.23–1.41) do të reduktohen në masën 50% të vlerës përkatëse të dhënë në pasqyrë, në rastin kur pronari i patentës ka deklaruar me shkrim gatishmërinë e tij për dhënie licence, në përputhje me nenin 49, pika 1 e ligjit nr. 9947, datë 7.7.2008 "Për pronësinë industriale".

* Tarifat vjetore për ripërtëritjen e patentave (nr. rendor 1.23–1.41) do të rriten në masën 50% të vlerave përkatëse të dhëna në pasqyrë, në rastet kur pagesa e tyre kryhet pas përfundimit të afatit të caktuar në ligj, por brenda një periudhe 6-mujore nga përfundimi i këtij afati, në përputhje me parashikimin e nenit 41, pika 3 e ligjit nr. 9947, datë 7.7.2008, "Për pronësinë industriale".

* Tarifat vjetore për ripërtëritjen e patentave (nr. rendor 1.23–1.41) do të rriten në masën 100% të vlerave përkatëse të dhëna në pasqyrë, në rastet kur pagesa e tyre kryhet brenda 2 muajve pas përfundimit të afatit të caktuar në përputhje me parashikimin e nenit 41, pika 3 e ligjit nr. 9947, datë 7.7.2008, "Për pronësinë industriale.

* Tarifat me nr. rendor 1.1, 1.4, 1.6, 1.7, 1.8, 1.9, 1.11, 1.12, 1.13 do të reduktohet në masën 50% të vlerës përkatëse të dhënë në pasqyrë, në rastin kur pronari i patentës është njëkohësisht edhe shpikësi i patentës. Për studentët, pensionistët, personat me aftësi të kufizuar, këto tarifa do të jenë 100 lekë.

Lidhja nr. 5

V. TABELA E TARIFAVE TË MARKAVE

Nr.	Llojet e tarifave	Vlera në lekë
5.1	Tarifë për depozitimin e aplikimit për markë individuale	7000
5.2	Tarifë për depozitimin e aplikimit për markë kolektive ose certifikuese	8000
5.3	Tarifë për çdo klasë shtesë	2500
5.4	Tarifë për kufizimin e listës së mallrave	5000
5.5	Tarifë për ndarjen e aplikimit fillestar	6000
5.6	Tarifë për ekzaminim jashtë numrit rendor	6000
5.7	Tarifë për regjistrimin e markës	8000
5.8	Tarifë për kundërshtimin e regjistrimit të një marke në Dhomën e Kundërshtimeve	7000
5.9	Tarifë për rivendosjen në afat	7000
5.10	Tarifë për zgjatjen e afatit	2000
5.11	Tarifë për shfuqizimin/zhvlerësimin e një marke në dhomën për shfuqizim /zhvlerësim	7000
5.12	Tarifë për apelimin në Bordin e Apelit të vendimit të marrë në lidhje me kërkesën për shfuqizim/zhvlerësim nga Dhoma për shfuqizimin/ zhvlerësim	10000
5.13	Tarifë për apelimin në Bordin e Apelit të vendimit të marrë nga Dhoma për Shqyrtimin e Kundërshtimeve	10000
5.14	Tarifë për apelimin në Bordin e Apelit të vendimit të marrë në lidhje me apelimin e refuzimit nga Dhoma për Shfuqizim /Zhvlerësim	10 000
5.15	Tarifë për apelim të refuzimit në Dhomën për Shfuqizim /Zhvlerësim	5000
5.16	Tarifë për ripërtëritjen e markës	8000
5.17	Tarifë për ripërtëritjen për çdo klasë shtesë të markës	4000
5.18	Tarifë për regjistrimin në regjistër të transferimit të pronësisë	5000
5.19	Tarifë për regjistrimin në regjistër të ndryshimit në emër	5000
5.20	Tarifë për regjistrimin në regjistër të ndryshimit në adresë	1000
5.21	Tarifë për regjistrimin në regjistër të kontratës së licencë	5000

5.22	Tarifë për regjistrimin në regjistër të kontratës së pengut	5000
5.23	Tarifë për regjistrimin në regjistër të veprimeve përmbarimore	5000
5.24	Tarifë për lëshimin e dokumentit të prioritetit	3000
5.25	Tarifë për transferimin e aplikimit për regjistrim ndërkombëtar të markës dhe transferimi për shtrirje të mëvonshme	5000
5.26	Tarifë për lëshim ekstrakti nga regjistri i markave	1000
5.27	Tarifë për lëshim dublikati të akteve administrative	1000
5.28	Tarifë për inspektim dosje	1000
5.29	Tarifë për hetim	1000
5.30	Tarifë për dorëheqje nga marka e regjistruar	3000
5.31	Tarifë për saktësimin e të dhënave në regjistër	2 000
5.32	Tarifë për pasqyrimin e ndryshimeve të tjera në regjistër	5 000
5.33	Tarifë për transformimin e një aplikimi ndërkombëtar në një aplikim kombëtar	7 000

a) Nëse është depozituar kërkesë për regjistrim ndërkombëtar të markës së aplikuar, tarifa për ekzaminim jashtë numrit rendor do të reduktohet në masën 50%.

b) Tarifa për ripërtëritjen e markës sipas pikës 5.16 do të rritet në masën 50% të vlerës së dhënë në pasqyrë, në rastet kur pagesa e saj kryhet brenda periudhës gjashtë-mujore nga data e përfundimit të periudhës së mbrojtjes.

c) Tarifa për lëshimin e certifikatës së markës në formë elektronike do të reduktohet në masën 20% të vlerës së tarifës së regjistrimit.

Lidhja nr. 8

VIII. TABELA E TARIFAVE TË SHËRBIMEVE TË TJERA

Nr.	**Llojet e tarifave**	**Vlera në lekë**
8.1	**TARIFAT PËR PËRFAQËSUESIT E AUTORIZUAR**	
8.1.1	Tarifë për pjesëmarrje në testimin kualifikues për përfaqësues të autorizuar	5000
8.1.2	Tarifë për ripërtëritje të licencës për përfaqësues të autorizuar	5000
8.1.3	Tarifë për ndryshimet në regjistër të përfaqësuesve të autorizuar	1000
8.1.4	Tarifë për marrjen e licencës për përfaqësues të autorizuar	10000
8.1.5	Tarifë për publikimin në faqen zyrtare të DPPI-së	1000
8.2	**TARIFAT PËR EKSPERTËT E PI-së**	
8.2.1	Tarifë për pjesëmarrje në testimin kualifikues për ekspert të PI-së	5000
8.2.2	Tarifë për ripërtëritje të licencës për ekspert të PI-së	5000

8.2.3	Tarifë për ndryshimet në regjistër të ekspertëve të PI-së	1000
8.2.4	Tarifë për marrjen e licencës për ekspert të PI-së	10000
8.2.5	Tarifë për publikimin në faqen zyrtare të DPPI-së	1000
8.3	**TARIFAT E QENDRËS SË TRAJNIMEVE NË FUSHËN E PI-së**	
8.3.1	Tarifë për pjesëmarrje në trajnimet e organizuara nga Qendra e Trajnimeve në Fushën e Pronësisë Industriale të DPPI-së	700/orë